



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10 paragrafi 3, nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 27.05.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. HYSNI HASANI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Ashkanlinjëve të Kosovës- PDAK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Qerim Gara.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, që ky vendim t'i komunikohet z. Hysni Hasani, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 24.05.2019, Nr.575/2019, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z. Qerim Gara, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të marrjes së pozitës së re të Nënkryetarit të Komunës për Komunitete.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është, z. Hysni Hasani nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 27.05.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka